

Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018

Objekti: Rikonstruksion i rrugës Him Kolli, Tiranë

Investitori: Bashkia Tiranë

Vlera e Investimit: 9,773,652 lekë

Periudha kohore: Janar 2013 deri në Shtator 2013

Inspektimi është kryer: Shkurt 2019

Ky objekt zbatohet brenda Unazës së Mesme të Tiranës, në një rrugë në afërsi të qendrës së saj. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i rrugës "Him Kolli", me rrugen kryesore "Rruga e Kavajës", dhe përfundon në bashkimin e këtij segmenti me rrugën tjetër kryesore "Myslym Shyri", me një gjatësi të përgjithshme rreth 410 metra lineare. Gjendja ekzistuese e rrugës ka qenë pjesërisht e amortizuar, kjo edhe për shkak të mosinvestimit në të, për një periudhë kohore të gjatë.



Fig. 1
Verehet një demtim i kunetave anesore të rrugës për shkak të mungesës së kanalizimeve kulluese dhe akumulimit të ujrave të shirave për një kohë të gjatë

Projekti ka ndërhyrë në rehabilitimin e shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me binder dhe shtrimin me asfalt), në rehabilitimin e plotë të shtresave të dëmtuara të trupit të rrugës me të gjitha komponentet e saj vetëm në disa pjesë të saj, në rehabilitimin e rrjetin e ujrave të bardha, me sistemimin e të gjitha kanalizimeve e pusetave të ujrave të zeza, në sistemimin e pjesshëm të trotuareve, etj. Projekti zbatimit ka parashikuar një rikonstruksion të pjesshëm të këtij segmenti rrugor.

Punimet kanë filluar në Janar të vitit 2013, ndërkohë që është bërë inagurimi për përfundimin e saj në muajin Shtator 2013, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Afati i garancisës së punimeve për këtë objekt ndërtimi është dy vjet. Pra rezulton se afati kohor i garancisës së punimeve të veprës, tashmë ka përfunduar. Duhet të përmendim se zbatimi i

punimeve është bërë në kushte të vështira, pasi rruga ka patur trafik të rënduar dhe bllokimi i saj është bërë me vetëm me periudha të shkurtra kohore. Edhe pse objekti është përfunduar vetëm para disa viteve, cilësia e zerave kryesore të punimeve lë për të dëshiruar.

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- Trupi i rrugës ka dëmtime (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit (nuk është bërë sipas standartit sistemimi i nënshtresave që kanë qenë të dëmtuara), nënshtresat e asfaltit janë me trashësi të vogël, duke parë kategorinë e fluksin e levizjeve në këtë segment rrugor. Ka sipërfaqe të shtresës së asfaltit e cila ka filluar që të thërmohet e të shkeputet (gjë që tregon se shtresa nuk është material cilësor dhe sipas standarteve),

Fig. 2

Ka ndwrrhyrje nw shtresat asfaltike te rruges, me riparime te cilat nuk jane kryer sipas standardeve te kerkuara, çfare ka cuar ne nje ulje te nivelit te shtresave asfaltike te pjeseve te riparuar, ne krahasim me shtresat fillestare te rruges



- Vihen re ulje dhe plasaritje të kunetave anësore të betonit (aty ku ato janë bërë, pasi ka edhe pjesë të rrugës ku nuk ka kuneta betoni). Trotuaret e kësaj rruge nuk janë bërë uniformë apo me gjerësi të njëtrajteshme. Një pjesë e trotuareve janë realizuar vetëm me shtresë betoni të derdhur. Në disa pjesë të rrugës ato pothuajse mungojnë, për shkak të mureve të shtëpive të banimit, apo ndërtimeve pa kriter të kryera pranë rrugës.
- Nuk janë respektuar sipas standartit të kërkuar lidhja e trotuareve, me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa segmente ato pothuajse mungojnë fare).
- Ka puseta të dëmtuara apo me parete anësore të betonit të tyre të dëmtuar.
- Ka kapakë të pusetave të dëmtuar apo të vjedhur.
- Vihen re plasaritje dhe dëmtime të kunetave anësore të rrugës,
- Lidhja e trupit kryesor të rrugës me segmentet anësore të saj, nuk është bërë uniformë.

- Në pjesën kryesore të ditës, një pjesë e këtij segmenti rrugor aktualisht (ne nisje nga krahu i Rrugës së Kavajës) është pothuaj i bllokuar nga tregëtarët e shitjes së fruta-perimeve, të cilët përdorin trupin e rrugës për shitjen e produkteve të tyre.



Fig. 3

Trupi i rruges ka demtime te shumta, disa prej te cilave jane riparuar ne menyre te papershtatshme, gje qe ka cuar ne demtimin e integritetit te shtresave asfaltike dhe therrmimin e tyre.

Edhe pse kane kaluar vetëm pak vite nga ndërtimi i këtij objekti (viti 2013), cilësia e punimeve të tij lë për të dëshiruar. Bashkia Tiranë si Investitore e këtij objekti, ka gjithë detyrimin ligjor për kontrollin e zbatimit të punimeve të ndertimit. Jam i mendimit se si nga Mbikqyrësi i punimeve, por edhe nga Bashkia Tiranë, ka pasur neglizhencë në kontrollin e zbatimit të punimeve të këtij segmenti rrugor. Gjithashtu Bashkia Tiranë në rolin e Investitorit duhet të evidentojë të gjitha kompanitë që kanë kryer punime zbatimi pranë saj dhe të marrë masa ndaj të gjitha kompanive të cilat kanë ndërtuar me cilësi të dobët, siç edhe është ky objekt i financuar me fonde nga Buxheti Shtetit.

Konkluzione në lidhje me objektin.

- *Do duhen të riparohen të gjitha dëmtimet e shtresave të asfaltit në trupin e rrugës.*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar duke bërë lidhje të njëtrajteshme të tyre, me trupin e rrugës e pa pengesa.*
- *Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza dhe plotësimi i tyre me kapakët metalikë (të dëmtuara apo edhe të vjedhura).*
- *Të bëhet riparimi i kunetave anësore të rrugës në segmentet e dëmtuara të saj,*

-
- *Për banorët që kanë ndërtime buzë rrugës kryesore të bëhet njoftimi zyrtar i tyre nga Bashkia Tiranë, për të mos lejuar investime të mëtejshme të tyre (flas për ndërtime të kryera edhe pa leje), për të mos u perballur në të ardhmen me kosto të shtuar për shpronësimin e tyre, nisur kjo nga nevoja imediate e zgjerimit të këtij segmenti rrugor.*
 - *Bashkia Tiranë të marrë masa të menjëhershme për lirin e gjithë hapësirave të kësaj rruge, nga tregëtarët e ndryshëm që shesin produktet e tyre, duke u bërë shkak për aksidente e trafik të rënduar.*
 - *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e difekteve të verejtura mendoj së ze rreth 20 deri 25 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarte të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

Bashkëlidhur një foto ajrore e zonës ku është investuar.
(me vije blu është shënuar rruga ku është kryer rikonstrukcioni)

